



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor
Prokuroria Themelore Prishtinë / Osnovno Tužilaštvo Prishtina / Prishtina Basic
Prosecution
Autoriteti Kompetent / Kryeprokurori

AD.nr.10/2024

Datë: 17.07.2024

Autoriteti Kompetent, duke vendosur lidhur me ankesën disiplinore nga z. L. [REDACTED] TH [REDACTED] ndaj prokurorit R. [REDACTED] P. [REDACTED] Prokuror në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, në bazë të nenit 9, paragrafi 1, pika 1.5 dhe paragrafi 6, të Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, me datë 17.07.2024 merr këtë:

V E N D I M

Refuzohet ankesa kundër R. [REDACTED] P. [REDACTED] Prokuror në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, pasi që duke u bazuar në nenin 6, paragrafi 2, pika 2.1 dhe 2.2 të Ligjit Nr.06/L-057, për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, veprimet e prokurorit nuk paraqesin shkelje disiplinore.

A r s y e t i m

Me datë 27.06.2024, Kryeprokurori, duke qenë në cilësinë e Autoritetit Kompetent, nga parashtruesi i ankesës L. [REDACTED] TH [REDACTED] ka pranuar ankesën disiplinore kundër R. [REDACTED] P. [REDACTED] Prokuror në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, me pretendimet se prokurori i lartcekur, në lëndën penale nën shenjë PP.II. [REDACTED], ka shkelur procedurat sa i përket ngritjes së aktakuzës, duke ndërmarrë veprime diskriminuese, trajtim jo të barabartë, në mungesë të pavarësisë, transparencës dhe paanshmërisë, ashtu që pretendon se prokurori R. [REDACTED]

P[REDACTED] është përfshirë në shkelje disiplinore të parapara me Ligjin Nr.06/L-057, për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, nenin 6, paragrafi 2, pika 2.1 dhe 2.2 të ligjit në fjalë.

Autoriteti Kompetent, pas analizimit dhe trajtimit të detajuar të kësaj çështje, konsideron se pretendimet e ngritura ankimore nuk paraqesin bazë të mjaftueshme dhe të arsyeshme për të rekomanduar fillimin e procedurës disiplinore ndaj prokurorit Rr[REDACTED] P[REDACTED].

Veprimet e Autoritetit Kompetent:

- Me datë 27.06.2024, Autoriteti Kompetent ka regjistruar ankesën disiplinore me numër AD.nr.10/2024.
- Me datë 08.07.2024, Autoriteti Kompetent ka njoftuar Kryesuesin e Këshillit Prokurorial të Kosovës, përmes Letër Informimit, për pranimit e ankesës.

Të gjeturat e Autoritetit Kompetent:

Prokuroria Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm me datë 15.06.2023, nga Policia e Kosovës, Stacioni Policor Qendra, ka pranuar kallëzimin penal me numër të rastit [REDACTED], të datës 15.06.2023, kundër të dyshuarit L[REDACTED] Th[REDACTED] në drejtim të veprës penale Ngacmimi, nga neni 182 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (Tutje KPRK).

Me të pranuar kallëzimin penal, lënda është regjistruar dhe i është ndarë për trajtim Departamentit të Përgjithshëm të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, respektivisht prokurorit Rr[REDACTED] P[REDACTED] ku i njëjti pas shqyrtimit të kallëzimit penal dhe provave të bashkëngjitura, me datë 28.08.2023 ka ngritur aktakuzën PP/IL.nr.[REDACTED] me kërkesë për dhënien e urdhrit ndëshkimor, kundër të pandehurit L[REDACTED] Th[REDACTED] për veprën penale Ngacmimi, nga neni 182, paragrafi 1 i KPRK-së, duke e dërguar çështjen pranë gjykatës kompetente.

Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, përmes Aktgjykimit .nr.2929/2023 të datës 30.08.2023, duke vendosur jashtë seancës ka pranuar kërkesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm PP/IL.nr.[REDACTED] të datës 28.08.2023, me ç'rast ndaj të akuzuarit L[REDACTED] Th[REDACTED] ka dhënë urdhër ndëshkimor duke e gjykuar me dënim me gjobë në shumë prej 500 euro.

Duke analizuar lëndën penale PP/II.nr. [REDACTED] pretendimet e parashtruesit të kësaj ankese disiplinore si dhe veprimet e ndërmarra nga prokurori Rr. [REDACTED] P. [REDACTED] Autoriteti Kompetent vlerëson se veprimet e tij në trajtimin e kësaj çështje penale nuk përbëjnë shkelje disiplinore.

Veprimet e ndërmarra pas hapjes së rastit

- Marrja e raportit nga ana e prokurorit Rr. [REDACTED] P. [REDACTED] mbi pretendimet ankimore.
- Shqyrtimi i shkresave të lëndës penale PP/II.nr. [REDACTED]

Pretendimet e palës ankuese

Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prishtinë, në cilësinë e Autoritetit Kompetent, me datë 27.06.2024, nga parashtruesi i ankesës disiplinore z. L. [REDACTED] Th. [REDACTED] ka pranuar ankesën disiplinore ndaj prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamentit të Përgjithshëm, z. Rr. [REDACTED] P. [REDACTED]. Në ankesën disiplinore të tij, pala ankuese i cili në lëndën penale PP/II.nr. [REDACTED] ka cilësinë e të pandehurit në procedurë, i njëjti pretendon se prokurori i çështjes Rr. [REDACTED] P. [REDACTED] me ngritjen e aktakuzës PP/II.nr. [REDACTED] ka kryer shkelje procedurale, është përfshirë në veprime diskriminuese, trajtim jo të barabartë ndaj tij, ka vepruar në mungesë të pavarësisë, transparencës dhe paanshmërisë, duke pretenduar se veprimet e tij korrespondojnë me shkelje disiplinore nga neni 6, paragrafi 2, pika 2.1 dhe 2.2 të Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Tutje në ankesën e tij disiplinore, pala ankuese ka theksuar se ndaj tij është zhvilluar një proces i orkestruar për të dëmtuar reputacionin e tij si person publik, i është shkelur e drejta e ruajtjes së fshehtësisë në proces si dhe është shkelur parimi i prezumimit të pafajësisë deri në vendim të plotfuqishëm. Shton se persona të tjerë, duke përfshirë edhe kolegët janë njoftuar përmes gjykatës se ankuesi është dënuar për një vepër penale, duke e dërguar aktgjykimin në zarf të hapur, dhe për veprime jo të ligjshme të gjykatës i është nënshtuar presioneve dhe etiketimeve personale e familjare nga më të ndryshme në vendin e tij të punës. Pala ankuese po ashtu pretendon se prokurori i çështjes, Rr. [REDACTED] P. [REDACTED] ka raporte shumëdimensionale me motrën e palës së dëmtuar dhe të dëshmitarit në këtë çështje penale, duke aluduar se ajo është bashkëpunëtorë dhe mike e prokurorit në fjalë. Tutje ankuesi thekson se ndaj tij është ngritur aktakuza dhe i njëjti është dënuar pa qenë fare i informuar mbi procesin, me ç'rast pretendon se është tejkaluar afati i përgjithshëm për njoftimin e palës në procedurë.

Deklarimet e Prokurorit Rr. [REDAKTUAR] P. [REDAKTUAR] lidhur me pretendimet ankimore

Prokurori Rr. [REDAKTUAR] P. [REDAKTUAR], përmes raportit të dorëzuar tek Autoriteti Kompetent me datë 09.07.2024, lidhur me pretendimet e ankuesit, ndër të tjera ka deklaruar se: "Bazuar në shkresën e datës 27.06.2024 të paraqitur nga pala ankuese L. [REDAKTUAR] T. [REDAKTUAR] me pretendimin se unë kam bërë shkelje procedurale, deklaroj se aktakuza kundër të pandehurit është ngritur datë 28.08.2023, bazuar në Kallëzimin penal me Nr. Rasti [REDAKTUAR] i datës 15.06.2023 si dhe shkresave tjera të lëndës, të pranuar më datë 19.06.2023 në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm. Aktakuza është ngritur me kërkesë për dhënien e urdhrit ndëshkimor bazuar në nenin 493 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës. Dua t'iu njoftoj se, para ngritjes së aktakuzës unë personalisht përmes telefonit kam kontaktuar palën e dëmtuar, dhe e kam njoftuar për mundësinë që e parasheh ligji që kjo çështje të zgjidhet përmes procedurës së ndërmjetësimit, kurse pala e dëmtuar NUK është pajtuar që kjo çështje të referohet në procedurën e ndërmjetësimit. Dua të shtojë se jam jo vetëm i befasuar, por edhe i ofenduar moralisht dhe profesionalisht me pretendimin e palës, i cili në parashtrësën e tij pos tjerash shkruan "Raporti i prokurorit me motrën e ankueses dhe dëshmitarit në rastin tim është shumë dimensional". Unë personin në fjalë, për të cilën pala ankuese i referohet si "shoqen, miken, bashkëpunëtoreshen e Prokurorit në rastin tim", NUK e njoh fare, madje e njëjta as nuk është dëshmitare e rasti, nuk ka dhënë deklaratë as në polici dhe pasi që nuk ka dhënë deklaratë në polici, as nuk është ftuar nga gjykata! Unë në rastin në fjalë e kam ngritur aktakuzën, pasi që nga shkresat e bashkangjitura lëndës jam bindur se i pandehuri ka kryer veprën në fjalë, dhe pasi që paraprakisht pala e dëmtuar nuk ishte pajtuar që rasti të referohet në procedurën e ndërmjetësimit.

KONKLUDIM

Në cilësinë e Autoritetit Kompetent, konsiderojmë se në veprimet e prokurorit Rr. [REDAKTUAR] P. [REDAKTUAR] nuk gjejmë elemente të shkeljeve disiplinore të pretenduara nga pala ankuese, të cilat do të binin ndesh me Ligjin Nr.06/L-057, për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Autoriteti Kompetent, pas pranimit të ankesës disiplinore nga ana e palës ankuese, ka vlerësuar të gjitha pretendimet e palës ankuese, ka shqyrtuar shkresat e lëndës penale PP/IL.nr. [REDAKTUAR], ka kërkuar raport me shkrim nga prokurori Rr. [REDAKTUAR] P. [REDAKTUAR] ndaj të cilit është ushtruar ankesa disiplinore dhe pas ndërmarrjes së këtyre veprimeve, në kuptim të nenit 9, paragrafi 6, të Ligjit

për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, ka ardhur në përfundim se ankesa disiplinore është e pabazuar dhe se prokurori R. [REDAKTUAR] P. [REDAKTUAR] nuk është përfshirë në veprime të cilat përbëjnë shkelje disiplinore.

Pretendimet e palës ankuese se prokurori R. [REDAKTUAR] P. [REDAKTUAR] ka bërë shkelje procedurale duke ngritur aktakuzën kundër tij, ky pretendim nuk qëndron për arsyet si në vijim:

Nga shqyrtimi i kallëzimit penal dhe provave të bashkëngjitura të pranura nga Policia e Kosovës, prokurori R. [REDAKTUAR] P. [REDAKTUAR] ka ngritur aktakuzë me kërkesë për dhënien e urdhrit ndëshkimor, meqenëse tek i njëjti është krijuar dyshimi i bazuar mirë, e cila është bazë për ngritjen e aktakuzës, se i pandehuri L. [REDAKTUAR] T. [REDAKTUAR] ka kryer veprën penale Ngacmimi nga neni 182, paragrafi 1 i KPRK-së. Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (tutje KPPRK), në nenin 99, paragrafi 2 lidhur me nenin 234 paragrafi 1, ka paraparë mundësinë ligjore të Prokurorit të Shtetit për ngritje të aktakuzës pa zbatim të hetimeve, ndërkaq në nenin 493 paragrafi 1 është paraparë mundësia që për veprat penale për të cilat parashihet dënim me gjobë ose burgim deri në tri (3) vjet, me përjashtim të veprës penale të Dhunës në Familje të paraparë në Kodin Penal, për të cilat prokurori i shtetit është informuar në bazë të provave të besueshme nga kallëzimi penal, prokurori i shtetit mund të kërkojë në aktakuzë që gjykata të jep urdhër ndëshkimor, në të cilin të akuzuarit do t'i shqiptojë dënim përkatës pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor. Në rastin konkret, prokurori R. [REDAKTUAR] P. [REDAKTUAR] ka vendosur brenda kornizave të KPPRK-së, meqenëse për veprën penale Ngacmimi nga neni 182 paragrafi 1, ligjvënësi ka paraparë dënimin me gjobë ose me burgim deri në (3) vjet, e që maksimumi i lartësisë së dënimit për këtë vepër penale nuk e përjashton mundësinë ligjore të prokurorit të shtetit që të ngrit aktakuzë direkte me kërkesë për urdhër ndëshkimor. Kjo kërkesë është pranuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, e cila jashtë seancës me datë 30.08.2023 ka nxjerrë Aktgjykimin P.nr.2929/23, me të cilën ka pranuar kërkesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, dhe ka dhënë Urdhrin Ndëshkimor ndaj të akuzuarit L. [REDAKTUAR] T. [REDAKTUAR] duke e shpallur fajtor të njëjtin për veprën penale Ngacmimi nga neni 182 paragrafi 1 i KPRK-së dhe i ka shqiptuar dënimin me gjobë. Sidoqoftë, pala e pandehur apo mbrojtësi i tij, konform nenit 496 paragrafi 2 të KPPRK-së, ka pasur të drejtë që kundër urdhrit ndëshkimor të paraqes kundërshtimet e tij brenda afatit ligjor prej (8) ditëve si dhe të propozoj prova në dobi të mbrojtjes së tij, mundësi ligjore të cilën edhe e ka shfrytëzuar.

Pretendimet e palës ankuese se prokurori R. [REDAKTUAR] P. [REDAKTUAR] është përfshirë në veprime diskriminuese, trajtim jo të barabartë ndaj tij, ka vepruar në mungesë të pavarësisë,

transparencës dhe paanshmërisë, këto pretendime nuk qëndrojnë. Prokurori i çështjes me të shqyrtuar lëndën ka gjetur se ka prova të mjaftueshme të cilat e mbështesin dyshimin e bazuar mirë se i pandehuri T. ka kryer veprën penale që i është vënë në barrë, e në rrethana të tilla është udhëhequr nga përgjegjësia që i takon në ngritjen e aktakuzës dhe përfaqësimin e saj para gjykatës, konform nenit 8, paragrafi 1, pika 1.8 të Ligjit për Prokurorin e Shtetit. Autoriteti Kompetent nuk ka gjetur se prokurori R. P. ka vepruar në mënyrë diskriminuese, jo të barabartë apo të njëanshme në këtë çështje penale, përkundrazi veprimet e tij kanë qenë karshi autorizimeve të tij ligjore dhe kushtetuese.

Sa i përket pretendimeve të palës ankuese se prokurori R. P. ka raporte shumëdimensionale me motrën e të dëmtuarës dhe dëshmitarët në çështjen penale kundër tij, duke iu referuar të njëjtës si “mike dhe bashkëpunëtore e prokurorit të çështjes”, ky pretendim i ankuesit është në nivelin e spekulimeve dhe si i tillë nuk qëndron. Edhe prokurori R. P. në raportin e tij me shkrim, kategorikisht ka mohuar se personit të cilit i referohet pala ankuese, nuk e njeh fare, nuk është as dëshmitare e rastit, e as e ftuar në prokurori apo propozuar që të ftohet në gjykatë që të procedohet në cilësinë e dëshmitares.

Pala ankuese por tjerash në ankesën e tij disiplinore ka theksuar se ndaj tij është zhvilluar një proces i orkestruar për të dëmtuar reputacionin e tij si person publik, i është shkelur e drejta e ruajtjes së fshehtësisë në proces si dhe është shkelur parimi i prezumimit të pafajësisë deri në vendim të plotfuqishëm. Shton se persona të tjerë, duke përfshirë edhe kolegët janë njoftuar përmes gjykatës se ankuesi është dënuar për një veprë penale, duke e dërguar aktgjykimin në zarf të hapur, dhe për veprime jo të ligjshme të gjykatës i është nënshtruar presioneve dhe etiketimeve personale e familjare nga më të ndryshme në vendin e tij të punës. Së pari, Prokurori i Shtetit është institucion i cili vepron në bazë të Kushtetutës, rregullativës ligjore dhe konventave ndërkombëtare, me autorizim dhe përgjegjësi për ndjekjen penale të kryesve të veprave penale, gjithmonë duke u kujdesur në respektim të parimeve dhe rregullave mbi të cilat është krijuar ky institucion, duke u kujdesuar maksimalisht që të gjithë personat të trajtohen barabartë para ligjit, pavarësisht racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal. Se pala në procedurë gëzon reputacion publik apo jo, nuk është rrethanë që merret parasysh nga Prokurori i Shtetit, meqenëse është parim kushtetues dhe ligjor që të gjithë personat të trajtohen barabartë para ligjit, e mbi këtë parim ka vendosur edhe prokurori R. P., subjekt i kësaj ankese disiplinore.

Si Autoritet Kompetent nuk kemi evidentuar ndonjë shkelje për sa i përket parimit të prezumimit të pafajësisë apo fshehtësisë në proces nga ana e prokurorit R. [REDACTED] P. [REDACTED] ndërkaq fakti se aktgjykimi është dërguar në zarf të hapur, me ç'rast kanë marrë dijeni persona të tjerë për procedurën që është duke u zhvilluar ndaj të pandehurit, këtu palës ankuese L. [REDACTED] T. [REDACTED] që për veprime të tilla të gjykatës i është nënshtruar presioneve dhe etiketimeve personale e familjare, kjo nuk është një çështje që mund të trajtohet nga ne si Autoritet Kompetent. Kryeprokurori është Autoritet Kompetent në trajtimin e ankesat disiplinore të personave fizik apo juridik për sa i përket pretendimeve për shkelje disiplinore të prokurorëve të punësuar në prokurorinë për të cilën është përgjegjës Kryeprokurori, andaj në këtë drejtim mbetet i kufizuar vetëm në trajtimin e kësaj ankese disiplinore sa i përket pretendimeve për shkelje disiplinore të prokurorit R. [REDACTED] P. [REDACTED]. Në rrethana të tilla, Kryeprokurori nuk ka kompetencë në trajtimin e shkeljeve të pretenduara disiplinore të gjyqtarëve, andaj nuk do të lëshohet fare në këtë pikë.

Sa i përket pretendimeve ankimore se i njëjti edhe pse i pandehur në procedurë nuk është njoftuar për ngritjen e aktakuzës, Autoriteti Kompetent ka gjetur se është një lëshim i paqëllimshëm nga ana e prokurorit R. [REDACTED] P. [REDACTED] për shkak të ngarkesës enorme me lëndë dhe numrit të madh të seancave gjyqësore, mirëpo që z. L. [REDACTED] T. [REDACTED] si palë e pandehur në ndërkohë është pajisur me shkresë të lëndës, e që ky lëshim i paqëllimshëm për shkak të stërngarkesës nuk ka pasur pasoja procedurale-juridike në humbjen e ndonjë afati ligjore, andaj si Autoritet Kompetent vlerësojmë se nuk ka bazë të mjaftueshme dhe të arsyeshme për të rekomanduar fillimin e procedurës disiplinore ndaj prokurorit R. [REDACTED] P. [REDACTED].

Në kontekst të veprimeve të lartpërmendura, si Autoritet Kompetent vlerësojmë se nuk është provuar se Prokurori R. [REDACTED] P. [REDACTED] ka kryer shkelje disiplinore, shkelje këto të cilat do të binin ndesh me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe do të paraqisnin bazë të mjaftueshme për parashtrimin e kërkesës për fillimin e hetimeve disiplinore ndaj prokurorit në fjalë, në kuptim të nenit 12, paragrafi 2 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Në cilësinë e Autoritetit Kompetent vlerësojmë se veprimet e prokurorit R. [REDACTED] P. [REDACTED] janë konform autorizimeve ligjore dhe kushtetuese të Prokurorit të Shtetit, dhe në asnjë veprim të prokurorit nuk janë gjetur elemente të shkeljeve disiplinore, që korrespondojnë në shkelje të dispozitave të procedurës penale, diskriminim, njëanshmëri apo konflikt interesi. Në këtë drejtim konsiderojmë se, veprimet e prokurorit R. [REDACTED] P. [REDACTED] kanë qenë në kuadër të ushtrimit të

funksiioneve prokuroriale në përputhje me legjislacionin në fuqi, në kuptim të nenit 5, paragrafi 2 të Ligjit nr.08/L-167 për Prokurorin e Shtetit.

Nga gjithë ajo çfarë u konstatua më lartë, kemi gjetur se nuk qëndrojnë pretendimet e palës ankuese, ngase në asnjë rast NUK është vërtetuar se veprimet e prokurorit paraqesin shkelje disiplinore në bazë të nenit 6, paragrafi 2, pika 2.1 dhe 2.2 të Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Në kuptim të nenit 9, paragrafi 6 të Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, ankesën disiplinore e **REFUZOJMË SI TË PABAZUAR**.

Me sa u cek më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:

-Këshillit Prokurorial të Kosovës

-Arkivës

